Kronikë

Librazhd/ Sherr për prona, 42-vjeçari qëllon me armë gjahu për të kërcënuar fqinjin, arrestohet

Një sherr për prona mes dy banorëve në fshatin Gizavesht, ka bërë që njëri prej tyre të qëlloj me armë gjahu - fatmirësisht në ajër.

Arma e gjahut e sekuestruar

Redaksia
24 Prill, 10:23 | **Përditësimi: 24 Prill, 10:33**

Share

Librazhd- Një sherr për prona mes dy banorëve në fshatin Gizavesht, ka bërë që njëri prej tyre të qëlloj me armë gjahu - fatmirësisht në ajër.

Sipas njoftimit të policisë 42-vjeçari i cili ra në prangat e policisë qëlloi më armë zjarri si shenjë kërcënimi ndaj fqinjit të tij 80-vjeç.

Fatmirësisht nga kjo situatë asnjëri prej tyre nuk u dëmtua.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Rama takim me gratë e Elbasanit/ Kryesocialisti: Ne të tallavasë jemi, kurse ata dëgjojnë Beethoven me Vrenozin në krye! 71 mandate i kemi të garantuara, na duhet një fuqi më e madhe

Ndërkohë arma e gjahut dhe municioni luftarak, që ishin pa leje u sekuestruan si provë materiale.

Njoftimi i policisë:

Menjëherë pas njoftimit se në fshatin Gizavesht, një shtetas kishte qëlluar me armë gjahu, në ajër, shërbimet e Komisariatit të Policisë Librazhd kanë shkuar në vendngjarje, me qëllim parandalimin e një ngjarjeje të mundshme kriminale dhe arrestimin e autorit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta operacionale, u kap në flagrancë dhe u vu në pranga shtetasi S. Xh., 42 vjeç.

Ky shtetas dyshohet se gjatë një konflikti për motive pronësie, me fqinjin e tij, shtetasin H. Xh., 80 vjeç, në fshatin Gizavesht, ka qëlluar me armë gjahu, në ajër, për ta kanosur atë.

Nga të shtënat nuk ka patur shtetas të dëmtuar.

U sekuestruan në cilësinë e provës materiale, arma e gjahut dhe një sasi municioni luftarak, që posedoheshin pa leje.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: arme gjahu | sherr per pronen | Elbasan | librazhd

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës: 23 Prill, 08:20
Si i vlerësoni tonet e përdorura deri më tani në fushatën e 11 majit?

Të qeta | Agresive | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Rama pritet me cyle në Gramsh: Nëse ne s'e donim SPAK-un, pse ia dhamë 'kodet e shtëpisë'? Këneta vrau disa herë, e Dumani s'thirri njeri! Me integrimin në BE, bufi s'e prek dot reformën
24 Prill, 16:53

Rama takim me të rinjtë në Belsh: Mos nënvlerësoni rëndësinë e votës, jeni faktor kryesor në procesin demokratik! Kapërceni 'zhgarravinat' e ekraneve dhe rrjeteve sociale
24 Prill, 15:08

Dorëhiqet Drejtori i Burgut të Peqinit, Florenc Doka! U emërua në dhjetor 2023
24 Prill, 11:44

PS prezanton 'Paqen Fiskale': 'Falim' detyrimet e gjobat e bizneseve me të vjetra se 10 vite! Rama: S'ka kontrolle me ata që negociojnë me shtetin për fitimin vjetor

Raziela Myslimaj

24 Prill, 11:42

'Nxënësit do marrin pjesë në takimet e Ramës në Elbasan', Bora Muzhaqi i përgjigjet Berishës: O buf gënjeshtar, nuk të ka mbetur më as turp e as logjikë
24 Prill, 10:27

Zgjedhjet/ 'Shqipëria Bëhet' prezanton kandidatët në Elbasan, Lapaj: Rama nuk e ka shumicën! Shabani: Të dyja palët janë pjesë e pazareve
22 Prill, 15:37

'Shqipëria Bëhet' prezanton kandidatët në Elbasan, Endri Shabani: Pasi na kanë marrë paratë dhe pronat, të mos i lejojmë të na marrin edhe krenarinë
20 Prill, 20:14

Berisha nga Elbasani: Paratë e subvencioneve të BE nuk i morën fermerët, por Rama me suitën e tij! Hapi kufijtë për prodhimet serbe
20 Prill, 17:47

Denoncon PD: Në Elbasan polici kthen pronën publike në private, institucionet mbyllin sytë
20 Prill, 16:00

Elbasan/ Po voziste me makinën që kishte vjedhur një natë më parë, arrestohet 19-vjeçari
20 Prill, 11:42

Elbasan/ Qindra besimtarë në meshën e shenjtë të Pashkëve në Kishën e Shën Kollit, Imzot Andoni: Të ndihmojmë dhe solidarizohemi me njëri-tjetrin
20 Prill, 11:26

'Rinia peng i vjedhjeve të 7x7=313', Basha me të rinjtë në Fier: Rama pretendon të luftojë korrupsionin e Belindën, këta të tjerët me Ilir Metën dhe Elvis Roshin
19 Prill, 19:08

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje